



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 5865 Prot.

Tiranë, më 11. 08. 2014

URDHËR

Nr. 329, datë 11. 08. 2014

"PËR

MBYLLJEN E FILIALIT TË UNIVERSITETIT PRIVAT "ALBANIAN UNIVERSITY" NË QYTETIN E FIERIT"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 41 të Ligjit nr. 9741, datë 21. 05. 2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e Filialit të Universitetit Privat "Albanian University" në qytetin e Fierit.
2. Filiali i sipërcituar që mbyllet ka detyrim:
 - a. Të mbyllë veprimtarinë akademike për të gjitha ciklet dhe programet e studimit;
 - b. Brenda datës 1 shtator 2014 të përgatisë dosjen për çdo student, që kërkon të transferohet, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe ta vërë atë në dispozicion të studentit pa detyrime financiare shtesë, apo të çfarëdolloji tjetër nga ana e studentit, për të mundësuar transferimin në institucione të tjera të arsimit të lartë, publike apo private, brenda apo jashtë vendit;
 - c. Për studentët që zgjedhin të mos transferohen në një institucion tjetër të arsimit të lartë, IAL-ja kryen transferimin e tyre në selinë qendrore në Tiranë dhe merr të gjitha masat për vijimin e mëtejshëm të studimeve pranë kësaj strukture.
3. Brenda datës 10 shtator 2014 filiali i Fierit të dorëzojë në Universitetin Privat "Albanian University", në Tiranë, të gjithë dokumentacionin ligjor, administrativ, financiar dhe akademik që disponon, dhe dosjet e studentëve, të përgatitura nga IAL-të, dhe që nuk janë tërhequr nga studentët përkatës, si dhe të përcjellë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit listën e studentëve që kanë kërkuar dosjet dhe çregjistrimin e tyre nga "Albanian University" për t'u transferuar në një institucion tjetër të arsimit të lartë.

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij Urdhri do të përballohen nga buxheti i Universitetit "Albanian University".
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe Universiteti "Albanian University".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në "Fletoren zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

